

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, si gjykatë penale e shkallës së parë, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.L. nga Prishtina rruga “.....”pa nr., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themeore në Ferizaj PP/II.nr.12-2/14 të dt.08.01.2015, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 14.10.2016, në prani të përfaqësuesit të aktakuzës - prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, i akuzuari dhe me autorizim av.A.L. nga Prishtina, të dëmtuarve R.A. dhe D.B., oficer policor në Stacionin Policor në Ferizaj, të njejtën ditë solli dhe publikisht kumtoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari G.L. nga Prishtina, rruga “.....” pn., data e lindjes.... në ....., nga i ati A. dhe e ëma K. , e gjinisë I., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri.

### Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sespe me dt.02.012014 rreth orës 02:00, në fshatin Prelez, Komuna Ferizaj derisa një njësi e trafikut rajonal ka qen duk e mbajtur një pike kontrolli, nga zyrtart policor R.A. #....., A.B. #..... dhe D.B. #....., ka ndaluar një veturë të markës “Fiat punto”, me targa ....., për shkak të tejkalimit të shpejtësisë dhe nga shoferi-i pandehuri G.L. i asaj veture, zyrtari policor A.B. ka kërkuar dokumentet derisa i ka shpjeguar arsyen e ndaljes dhe dokumentat e marrur i ka dërguar në drejtim të kolegëve të tij për ti shqiptuar tiketën ndërkohë nga vetura ka dalur i pandehurit dhe ka filluar të fyej e më pas me kanosje serioze ka tentuar që ta pengoj kryerjen e detyrës zyrtare duke përdorur fjalët “se shtrejtë keni me pagu ju nuk e dini me kanë keni punë”, të cilin më pas policia arrin ta prangosë.

Me çka ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 KPK-së

Andaj gjykata në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 4, 7,17, 41, 42, 43, 45,46, 47, 73,74,75, dhe 76 par.1.nënpar 1.6 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarin e

### G J Y K O N

Të akuzuarit **G.L.** i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 /një/ muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me

gjobë në shumën prej 200 / dyqind/ Euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, dënimi do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj një ditë burgimi.

Të dëmtuarit R.A. dhe D.B., oficer policor në Stacionin Policor në Ferizaj, nuk janë udhëzuar në kontest civil, pasi në shqyrtimin fillestar kanë hequr dorë nga kërkesa pasuroro-juridike.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën Ferizaj PP/II.nr.12-2/14 të dt.08.01.2015 me të cilin ka ngarkuar të akuzuarin G.L. nga Prihtina rruga “.....”pa nr., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 KPK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.14.10.2016 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, i akuzuari G.L. dhe i autorizuari i tij av.A.L. nga Prishtina si dhe të dëmtuarit R.A. e D.B., oficer policor në Stacionin Policor në Ferizaj.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën ka pranuar një kopje të aktakuzës, por nuk e kishte marr me vete në shqyrtim fillesta i autorizuari i tij avokati ka kërkuar ti ipet një ekzemplar i aktakuzës ku nga gjykata i’u është ofruar.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari G.L. ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar këtë pasi është e vërtet se ditën kritike ishte duke udhëtuar nga Ferizaji në drejtim të Prishtinës dhe kur ka arritur në pikën e kontrollit ku ishin patrulla e policisë dhe e kanë ndalë, ku tani është penduar nga veprimet që i ka ndërmarrur atë ditë, kërkon falje për atë që ka shkaktuar dhe i ka premtuar gjykatës së në të ardhmen nuk do të prësëris veprime të tilla apo të ngjashme, ka kërkuar nga gjykata që të më shqipton një sanksion penal më të but, pasi është i pa punë, babai i ka vdekur dhe tani jeton vetëm me nënën.

Mbrojtësi i të akuzuarit me autorizim av. Mr.sc.A.L. nga Prishtina ka deklaruar se mbështet mbrojtjen e klientit të tij meqë e ka të afërt-të familjes, babai i ka vdekur para tri viteve, ka kryer studimet por nuk është në marrëdhënje pune, pranon fajsinë dhe pendohet rëndë për atë që ka bërë, ky është i vetmi rast konkret ndaj të njëjtit, tani i është ofruar një vend pune në ..... ku ka punuar babai i tij dhe dëshirojnë që ti ndihmojnë dhe duke pas parasysh se ka qenë i moshës së re dhe është penduar shumë dhe premtun se nuk do të përsëris veprime të tilla në të ardhmen dhe duke parë se edhe u kërkohet falje policisë që janë këtu prezentë, ka kërkuar nga gjykata që të njëjtit ti shqiptohet denim sa më i butë në mënyrë që i njëjti në të ardhmen të mos përsëris veprime të tilla, mundësisht vërejtje gjyqësore apo denim me kusht që në të ardhmen do të ndikoj pozitivisht.

I dëmtuari R.A. deklaroi se mbetet në tërësi pranë delaratave të dhëna më heret gjatë procedurës së hetuesisë por nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike.

I dëmtuari D.B. deklaroi se mbetet në tërësi pranë delaratave të dhëna më heret gjatë procedurës së hetuesisë por nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike.

Gjyqtari në kuptim nën paragraf 248 par.1 nënparagraf 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe paragraf 4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të paragraf 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ndërsa gjykata me rastin e qacktimin të shqiptimit të dënimit pranimin e fajësisë mta këtë parasysh dhe të pandehurit të shqiptoj një sanksion të paraparë me ligj.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht leximin e deklaratës të pandehurit e datës 02.01.2014 dhe raportin e oficerit i datës 02.01.2014.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 KPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të paragraf 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për verprën e kryer, kërkim falje të dëmtuarve prezent në shqyrtim, mbajtës i familjes, i pa punë, rrethanat personale të kryesit dhe sjellejn e tij pas kryerjes së kësaj veprës penale, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj veprës penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi saksion penal si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe

personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konform dispozitave të nenit 461 të dëmtuarit nuk i ka udhëzuar në kontest civil pasi të njejtit kan hequr dor nga propozimi për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike.

Vendimi mbi kompensimin e paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P.nr.37/2015 i dt.14.10.2016**

**Asistenti**  
Muedin Rexhepi

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.